

VENDIM
Nr. 127, datë 23.3.2000

**PËR PËRMBAJTJEN DHE PROCEDURAT E PARAQITJES SË KËRKESËS DHE TË
NJOFTIMIT PËR SHPRONËSIMET DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM
TË PASURISË PRONË PRIVATE PËR INTERES PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 14, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private me interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet, standarde, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njoftimi për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik bëhet në bazë të formularit nr.2, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Njoftimi duhet të përmbajë objektin që ndërtohet, adresën e kërkuarit, objektin që shpronësohet, adresën e objektit që shpronësohet, listën emërore të të shpronësuarit, specifikimet e objektit që shpronësohet (zonën, qytetin, objektin, sipërfaqen, vëllimin), afatin, brenda të cilit duhet të fillojë shpronësimi, si dhe kërkuarin. Njoftimit i bashkëlidhet edhe raporti i specialistëve për gjendjen fizike të objektit, që shpronësohet apo merret në përdorim të përkohshëm.

4. Njoftimi me shkrim konsiderohet i marrë, në rast se i është dorëzuar personalisht marrësit ose në rast se është dorëzuar në selinë, vendbanimin ose në adresën postare të tij; nëse nga shqyrtimi i mundshëm i rrethanave nuk vërtetohet asnjëra prej këtyre rasteve, njoftimi me shkrim quhet i marrë po të jetë dërguar me letër rekomande ose me çdo mjet tjetër, ku regjistrohet vullneti për dorëzimin e njoftimit në adresën e fundit të ditur të selisë, të banesës ose në adresën postare.

Në qoftë se personi i interesuar refuzon të marrë në dorëzim njoftimin, atëherë personi i ngarkuar për bërjen e njoftimit bën shënimin përkatës në njoftim dhe, kur është e mundur, e vërteton me nënshkrimin e dy dëshmitarëve të pranishëm.

5. Njoftimi quhet i marrë në ditën e dorëzimit të tij.

6. Kur i interesuari nuk ka vendbanim, vendqendrim ose banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë ose nuk ka zgjedhur një banesë a nuk ka caktuar një përfaqësues, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në lagjen ose komunën e vendit ku ndodhet objekti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Objekti që do të shpronësohet _____

Ministritë _____

Kërkuari _____

Adresa e kërkuarit _____

Dokumenta që vërtetojnë gjendjen juridike të kërkuarit.

Projektet e miratuara në institucionet përkatëse.

Argumentimi ligjor për interesin publik të shpronësimit dhe shkaku për të cilin bëhet ky shpronësim.

Dokument financiar për garantimin e fondeve për realizimin e projektit, shpronësimit dhe atë të zhvlerësimit.

Masa e shpërblimit të parashikuar për secilin pronar.

Autorizimet dhe lejet e miratuara nga organet kompetente për realizimin e projektit.

Afatet dhe mënyrat e realizimit të projektit nga vetë kërkuuesi ose me të tretë.

Lista të pronarëve të pasurive pronë private.

Lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit.

Lista e personave të tretë që duhen të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që do të shpronësohet.

Për tre pikat e mësipërme të paraqiten shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, parashikimet për vlerësimin e pasurive dhe të drejtave, adresat dhe vendbanimet më të fundit të njohur të pronarëve dhe personave të tretë përkatës.

Hartë treguese në shkallën 1:1000 ose 1:2500

Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të konfirmojë listat e pronarëve brenda 10 ditëve

Hartë treguese në qendrat e banuara në shkallëm 1:500

Kërkuuesi

(.....)

NJOFTIM PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Të shpronësuarit Z. _____

Adresa _____

Adresa e objektit që do të shpronësohet _____

Si rezultat i ndërtimit të objektit _____

_____ objekt shpronësimi në bazë të nenit _____, të Ligjit Nr.8561, dt. 11.01.2000 “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, rezulton që sipas dokumentit të pronësisë ju jeni pronari/bashkëpronarë i/ të ligjshëm të objektit _____ me të dhënat e mëposhtme:

- Zonë kadastrale sipas hartës së regjistrimit

- Qyteti (adresa)

- Objekti (emërtimi)

- Sipëfaqja në m2

- Volumi në m3

për të cilën kërkuessit _____ brenda një afati prej _____ muaj/ditë i nevojitet për realizimin e ndërtimit të objektit _____.

Bashkëlidhur keni raportin e vlerësimit përfundimtar të mbajtur nga komisioni i posaçëm për shpronësim ngritur me urdhër të Ministrit Nr. _____, dt. _____ i cili procedon në bazë të V.K.M. Nr. _____ dt. _____ në lidhje me:

- masën e shpërblimit si pronar i shpronësuar në lekë/dollarë

- masën e shpërblimit si pronar i pasurisë së zhvleftësuar në lekë/dollarë

- masën e shpërblimit për kompensim si person i tretë për të drejtat për shkak të shpronësimit në lekë/dollarë

Në lidhje me vlerësimin e objektit që do të shpronësohet keni të drejtë që brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të paraqitni pretendimet tuaja në Ministrinë kompetente

Organi kompetent

Ministria _____.